REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KËSHILLI I MINISTRAVE**
**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

# VENDIM

Nr. 9, datë 29.12.2016

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "REHABILITIMI ME EFIÇENCË ENERGJETIKE I KONVIKTEVE TË QYTETIT STUDENTI NR. 2, BASHKIA TIRANË"**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", me propozim të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: "Rehabilitimi me efiçencë energjetike i konvikteve të qytetit Studenti Nr. 2, Bashkia Tiranë", me zhvillues Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë.

2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit zhvillues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.

4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT KËSHILLI I MINISTRAVE

**ZËVENDËS KRYETAR I KKT**

**EGLANTINA GJERMENI**

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN

**SEKRETAR I KKT**

**LEDIA TOTA**

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT